i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive,

---

porteve aeroportive etj.

#### **4. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE**

b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.

c- Ujësjetës-kanalizime urbane - rurale.

#### **5. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA**

a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

b- Projektim rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

#### **6. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI**

a- Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

#### **7. PROJEKTUES GJEODET**

a- Rivlime inxhinierike.

c- Sisteme GIS.

#### **8. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK**

d- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

#### **9. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.

#### **10. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR.**

a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

b- Sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

d- Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

#### **11. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/persona juridikë).**

b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

c- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës

rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

## ARGUMENTIMI

| KATEGORIA               | PERSHKRIMI I KATEGORISE                                                                                                                                                                                                                                                                                | ARGUMENTIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|-------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1.a, b-3,d</b>       | a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.<br>b-3. objekte spitalore; terminallet në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.<br>d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.                                             | Bazuar ne termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve të cilat do të kenë paraqitjen arkitekturore, si rrjedhojë gjykohet që kjo pike është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar.                                                                                |
| <b>2.a, b-2, c-2, d</b> | a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.<br>b-2. objekte me skelet metalik.<br>c-2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.<br>d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike | Bazuar ne termat e referencës, parashikohet realizimi i objekteve të cilat do të kenë struktura beton arme, objekte me skelet metalik si rrjedhojë gjykohet që kjo pike është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar.                                                        |
| <b>3 c, f, i</b>        | c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.<br>f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.<br>i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.                                              | Bazuar ne termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve të cilat do të kenë ndricim, si rrjedhojë gjykohet që kjo pike është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar.                                                                                                 |
| <b>4 b, c</b>           | b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.<br>c- Ujësjellës-kanalizime urbane - rurale..                                                                                                                                                                                                                | Bazuar ne termat e referencës për realizimin e nderhyrjeve të parashikuara, parashikohet realizimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve që do të përballojnë prurje të rrugëve etj, si rrjedhojë gjykohet që kjo pike është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar.          |
| <b>5 a, b</b>           | a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.<br>b-Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.                                                                                                                                                            | Bazuar ne termat e referencës parashikohet realizimi i rrugëve lokale dhe dytesore në varesi të qarkullimit dhe trafikut që do të përcaktohet në zhvillimin e projekteve të kësaj procedure, si rrjedhojë gjykohet që kjo pike është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar. |
| <b>6 a</b>              | a- Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.                                                                                                                                                                                                                                                           | Bazuar ne termat e referencës parashikohet realizimi i rrugëve lokale dhe dytesore si dhe realizimi i veprave                                                                                                                                                                                      |

|                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | te artit si mure mbajtes, mure prites, tombino, ura deri ne 10m, tombino box etj.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>7 a, c</b>     | a- Riveline inxhinierike.<br>c- Sisteme GIS.                                                                                                                                                                                                                                                         | Bazuar ne termat e references, kemi realizimin e projektit te rrugeve dhe rrjetit inxhinierik dhe si rrjedhoje gjykohet se eshte e nevojshme realizimi i rilevimeve inxhinierike per te gjithë infrastrukturen.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>8 d</b>        | d-Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.                                                                                                                                                                                                      | Bazuar ne termat e referencës parashikohet realizimi i rrugeve si dhe realizimi i veprave te artit si mure mbajtes, mure prites, tombino, ura mbi 10m, tombino box, kerkon studim gjeologo-inxhinierik te trojeve ku do te ndertohen keto vepra.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>9 e</b>        | a- Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.                                                                                                                                                                                                        | Bazuar ne termat e references ne rruget qe parashikohen te rikonstruktohen, parashikohet te realizohet ndricimi rrugor, ky i cili do te sigurohet nga lidhja me rrjetin elektrik ekzistues te tensionit te ulet dhe te mesem per furnizim, si rrjedhojë gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimit te kerkuar.                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>10 a, b, d</b> | a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.<br>b- Sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.<br>d- Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.. | Bazuar ne termat e references parashikohet rikonstruksioni i rrugeve, eshte e nevojshme parashikimi i realizimit te sinjalistikes jo ndricuese, tabela dhe vijezi horizontal, si rrjedhojë gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimit te kerkuar.<br><br>Bazuar ne termat e references parashikohet rikonstruksioni i rrugeve, eshte e nevojshme parashikimi i realizimit te sinjalistikes ndricuese, tabela dhe vijezi horizontal, si rrjedhojë gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimit te kerkuar. |
| <b>11 b, c</b>    | b-Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.<br>c- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës                                                                                           | Bazuar ne termat e references parashikohet rikonstruksioni i rrugeve, eshte e nevojshme te kryhen studime gjeologo sizmike dhe studime vlerwsi te sizmologjise, si rrjedhojë gjykohet qe kjo pike eshte e                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |

|  |                                                                          |                                                             |
|--|--------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|
|  | rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj. | nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar. |
|--|--------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
- 1 (nje) Topograf

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikues ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**2.3.4** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf mbështetës si më poshtë:

**1 (një)** Ekspert Zjarrëfikës- është i domosdoshëm të jete prezent gjatë hartimit të projekteve të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vlerësimeve perkatese të fushës bazuar në termat e references

**1 (një)** Ekspert Mjedisi të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis -gjykohet si i domosdoshëm për realizimin e VNM (Vlerësimet e ndikimit në Mjedis) për projektet që do të realizohen.

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikues ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**2.3.5** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 11 (njemdhjetë) punonjës për periudhën Mars-Maj 2025, i lëshuar nga Administrata Tatimore.

- 
- Listëpagesat për periudhën Mars-Maj 2025, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

#### **2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:**

- 1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;
- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën i) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**2.3.7** Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit/distributorit të autorizuar të mallrave objekt prokurimi. Konkretisht:

1. ISO 9001-2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.
2. ISO 14001-2015 “Standart për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”)/ekuivalente dhe e vlefshme.
3. ISO 45001:2018 “Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit nëpunë”)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

## Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës ( **Faza II**), duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vleres minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në prokurimin e kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, këto të fundit nuk kanë detyrimin e deklarimit të përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim. Secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

### Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

#### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

| Identifikimi                                                                                                                                               | Përgjigjja    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | -----         |
| Numri NIPT/et:                                                                                                                                             | -----         |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar                                                                                                            | -----         |
| Përfaqësuesi (emri):                                                                                                                                       | -----         |
| Telefoni:                                                                                                                                                  | -----         |
| E-mail:                                                                                                                                                    | -----<br>---- |

## B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|---------|-----------------------------|-----------------------------------------------------------|
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |

- Informacione për nënkontraktorin
- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori

**ekonomik**

| <b>Emri (at) e subjekteve</b> | <b>NIPT-i</b> | <b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b> | <b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b> |
|-------------------------------|---------------|-----------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|
|                               |               |                                                                             |                                             |
|                               |               |                                                                             |                                             |
|                               |               |                                                                             |                                             |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit****A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT****Deklarata**

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <p>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p> |
| <p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime</i> _____ <i>nëse</i> _____ <i>vlerësohet</i> _____ <i>e</i></p> <p><i>nevojshme</i> _____</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>7</sup>.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

#### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga

<sup>7</sup> Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

## D: DEKLARATA

### Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

|                                                                                                                                                                                                                    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Deklarata</b>                                                                                                                                                                                                   |
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:                                                                                                                                    |
| <ul style="list-style-type: none"><li>Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.</li></ul> |

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

### Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË

**Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:**

